



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.29.01.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Bajram Hashani (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Enver Gashi (LDK), Labinot Mirena (LDK), Abdylrahman Krasniqi (LDK), Linda Bekteshi (LDK), Vlora Mjekiqi Kabashi (LDK), Sami Ahmeti (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Mervete Shala (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Goran Dancetovic (SL), Biljana Spasic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës, Halil Thaqi, Berat Gashi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Besnik Salihu, zyrtar kryesor financiar, përf. e KFOR-it, përf. e OSBE-së dhe zyrtarët komunal.

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti financiar i shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025
4. Raporti i Performancës së Komunës për vitin 2024
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga DAP për dhënien në debat publik të Draft - Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
6. Plotësimi i Komitetit për komunitete
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimvendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga DEFZH për Plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale me nr.01-060-01-9738-24, të dt.04.04.2024
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të kompanisë KRM "Pastrimi"
10. Raporti i Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2025
11. Shqyrtimi i kërkesave
12. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohen ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 21 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Raportin financiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025 dhe për një shpjegim më të gjerë fjalën ia dha drejtorit të DEFZH-së.

Besnik Krasniqi – Sa i përket buxhetit për periudhën janar- dhjetor 2025, fjalën duhet t’ia kaloj Zyrtarit Kryesor Financiar sepse unë kam ardhur në fund të mandatit.

Besnik Salihu – Raportin e shpenzimeve për janar- dhjetor 2025 e keni të pranishëm nëse keni ndonjë pyetje, nuk do të isha ndalë me shpjegua me numra me rend për të humb kohë, nëse keni ndonjë pyetje unë jam i gatshëm me u përgjigj.

Kryesuesi – Duke qenë se kjo është vazhdimësi e punës së institucioneve ne jemi të vetëdijshëm që ky raport që e ka sjellë Drejtoria juaj drejtor ju nuk keni qenë në kohën kur janë bërë këto punë megjithatë, është vazhdimësi dhe është mirë që raportet ti sjellen Kuvendit, çdo vit siç është me rregulle.

Fjolla Nasufi - Ne jemi dakord me këtë pikë të rendit të ditës, nuk kemi ndonjë koment.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Nuk kemi asgjë sa i përket kësaj pike.

Goran Dancetovic – E kuptoj që drejtori i ri nuk ka marrë pjesë në zbatimin e këtij buxheti, por është e lavdërueshme që kreu i këtij departamenti është i pranishëm. E lexova raportin dhe e pashë atë në Zyrën për Komunitete - pagat dhe ndihmat financiare, mallrat dhe shërbimet, dhe pyes nëse ka ndonjë projekt tjetër përveç pagave e ndihmave financiare dhe mallrave dhe shërbimeve për këtë zyrë.

Besnik Salihu - Tek zyra e komuniteteve buxheti është i planifikuar prej Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe si çdo vit tjetër edhe këtë vit është i planifikuar në kuadër të kësaj Drejtorie.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti Raportin e Performancës së Komunës për vitin 2024.

Ariana Grajçevci - Sot po e paraqes Raportin e Përformancës së Komunës për vitin 2024, ky raport është pranuar nga MAPL dhe është përgatitur sipas Sistemit të Vlerësimit të Përformancës Komunale. Raporti tregon mënyrën se si ka funksionuar Komuna përgjatë gjithë vitit, tregon sfidat, rezultatet si dhe arritjet e Institucionit. Ky prezantim i raportit para Kuvendit komunal është obligim ligjor dhe ka për qëllim informimin e asambleistëve lidhur me fushat ku ka nevojë për përmirësim, kështu që në bazë të këtij raporti do të marrim masa për përmirësimin e mëtejshëm të performancës. Ndërsa si informacion shtesë sa i përket vitit 2025 raporti është në proces të përgatitjes dhe në momentin kur përfundohet ne do të prezantojmë në afatet e caktuara.

Fjolla Nasufi - Nuk kemi ndonjë koment shtesë, jemi dakord.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Nuk kemi asgjë sa i përket kësaj pike.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi- Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DAP për dhënien në debat publik të Draft - Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Ariana Grajçevci - Fillimisht ka qenë e planifikuar që Projekt-Kodi Etik sot të procedohet për dhënien në debat publik, mirëpo nga rekomandimet e auditorit dhe duke qenë se jemi në pritje të sqarimit zyrtar nga MPB lidhur me zbatimin e Rregullores 04/2015, kjo pikë për momentin paraqitet vetëm për informim dhe nuk procedohet për debat publik.

Kryesuesi- Do të thotë ju fillimisht e keni sjellë si kërkesë për dhënien në debat publik mirëpo tash propozoni që kjo pikë të hiqet prej rendit të ditës.

Ariana Grajçevci - Po kryesues ashtu është, me rekomandim të auditorit kjo nuk del për debat publik.

Fjolla Nasufi - Nuk kemi ndonjë koment as për këtë pikë të rendit të ditës.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Fjalën ia kaloj znj.Linda Bekteshit.

Linda Bekteshi - Besoj që kryesuesi është në dijeni për këtë pikë që e kemi dhënë edhe në debat publik e kemi dërguar në MAPL, dhe përgjegjja e MAPL-së ka qenë që Komuna duhet të bazohet në Kodin Etik të

MPB-së. Ju e dini që kemi kërkuar edhe sqarim nga MPB-ja, pse disa Komunave ju është lejuar ky Kod Etik, ndërsa Komunës së Obiliqit jo dhe deri më sot nuk kemi marrë as edhe një përgjegje, kështu që shpresoj që kësaj radhe ky Kod Etik të kaloj.

Kryesuesi - Realisht neve na është kërkuar nga Komisioni i themeluar më herët që të procedojmë në këtë pikë megjithatë, drejtoresha paska marrë informacione të duhura kështu që me rekomandimin e drejtoreshës ne nuk do e kishim trajtuar këtë pikë të rendit të ditës fare.

Kryetari – Meqë, sipas ish-drejtoreshës dhe tash asambleistës e cila thotë që në disa Komuna ka dhe i lejohet Kodi i Etikës, unë mendoj se duhet të shtyhet përpara pavarësisht që drejtoresha po thotë që na është kërkuar të shtyhet, unë kisha kërkuar prej juve, që të dërgohet në debat publik Draft- Kodi i Etikës për Zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Linda Bekteshi - Pajtohem me Kryetarin sepse ky ka qenë edhe rekomandim i Auditorit të Brendshëm që ne të vazhdojmë me Kodin Etik dhe tash duhet të gjejmë një mes se ku është problemi, kush ka drejtë a ne apo Minsitria.

Kryesuesi - Fakti që delë në debat publik nuk do të thotë që ndryshon ndonjë gjë veç i ndihmon kohës që sa më shpejt me procedue.

Ariana Grajčevci - Po me kërkesë të Auditorit, kështu që ne presim një konfirmim të MPB-së dhe nëse e shoh edhe Kryetari të arsyeshme që të mos dalë njëherë për njëherë në debat publik deri sa të sqarohet saktë.

Kryesuesi - Unë kisha procedue me pjesën e Kryetarit, sepse kjo do të jetë edhe një lloj presioni edhe për ata, kështu që ta shtyjme përpara këtë çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi- Paraqiti plotësimin e Komitetit për komunitete,

Kuvendi Komunal ka miratuar një përbërje prej 3 anëtarëve të Kuvendit, që ka qenë Mervete Shala, Muhamet Preniqi dhe Biljana Spasic. Mirëpo, Ministria vendimin nuk e ka aprovuar për shkak se ka shkuar jo i plotë. Me datën 14 janar në bazë të thirrjes publike që është bërë për përfaqësuesit e komuniteteve është mbajtur mbledhja e Komuniteteve, dhe janë zgjedhur përfaqësuesit e komuniteteve shtesë, edhe pse është bërë gabim që është thirrë edhe komuniteti serbë sepse në këtë rast komuniteti serbë e ka përfaqësuesin në Kuvend. Nga komuniteti boshnjak është zgjedhur znj. Sanela Mackic, nga komuniteti rom është zgjedhur Hajriz Kurti, pastaj Abdyl Mustafa dhe Faton Beka. Megjithatë, nga Ministria na është kërkuar që ky Kuvend ta ketë shumicën, që i bie të ketë 5 anëtarë në Kuvend me të paktën një përfaqësues të komuniteteve si dhe 4 komunitete të tjera përfaqësohen nga lista që veç se janë zgjedhur. Në këtë situatë vetëm tek Lista Serbe kisha kërkuar të kemi një debat, sipas Ligjit komunitetet të cilat përfaqësohen me më shumë se 10% të ligjit ju takon zëvendës kryesuesi i Kuvendit Komunal, që në takimet tona me MAPL-në na kanë thënë nuk mundet të jetë edhe në Komitete edhe zëvendës kryesues i KK. Në këtë rast në fillim ju keni propozuar Biljana Spasiqin, mirëpo sipas një kërkesë Goran Dancetovic ka bërë kërkesë të ja kaloj zëvendës kryesuesin e Kuvendit personit të dytë ndërsa MAPL, na ka thënë nëse është kështu duhet të tërhiqet prej Komitetit për Komunitete zonja Biljana Spasic, E në këtë rast mundeni me qenë ju Zotri Dancetovic, besoj që më keni kuptuar, nëse po e ndryshoni propozimin në lidhje me emrin tuaj .

Goran Dancetovic - Po përpiqem ta kuptoj se cili është mesazhi që Biljana nuk mund të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe sipas Statutit të Komunës së Obiliqit, nuk ka pozicion të Zëvendëskryetarit të Kuvendit, sipas ligjit është shkruar kështu. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ka 3,563 pakica, gjithsej 15.61% të popullsisë, dhe ne e përmbushim atë kërkesë për Zëvendëskryetar të Kuvendit, por unë nuk do ta pranoja këtë. Nëse mund të kontaktoni Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale për të kontrolluar nëse është e mundur që unë të mos e pranoj pozicionin dhe që kandidatja tjetër me numrin më të lartë të votave të jetë Biljana Spasic.

Kryesuesi - A jeni dakord ju që në Komitetin për Komunitete të ndryshohet emri nga Biljana Spasic tek ju.
Goran Dancetovic - Pajtohem që të më zëvendësojë Biljana në Komitetin për Komunitete, por ju kërkoj të kontaktoni Ministrinë me një kërkesë që unë me numrin më të madh të votave, të mos e pranoj pozicionin e Nënkrjetarit të Komunës, por dikush tjetër të jetë këshilltar i pakicës.

Kryesuesi - Faleminderit për këtë veç se e kemi pyetur, në këtë rast ju informojmë se si veprohet, dhe duhet të bëjmë një shkresë në drejtim të MAPL-së, megjithatë ju informojmë saktë se si bëhet. Atëherë shkojmë me propozimet, nëse jeni dakord propozimet paraprake që janë bërë i kishim lënë si të tilla, fillimisht Mervete Shala dhe Muhamet Preniqi janë aprovuar paraprakisht, mirëpo në propozimin e fundit i dhëmë edhe një herë në propozim. Atëherë përpos Mervetes zonja. Nasufi nga Lëvizja Vetëvendosje kush shkon në Komitetin për Komunitete.

Fjolla Nasufi - Nga Lëvizja Vetëvendosje propozojmë znj. Arbenita Pllana.

Kryesuesi - Pra nga Lëvizja Vetëvendosje është Mervete Shala dhe Arbenita Pllana. Zonja Mjekiqi Kabashi përveç Muhamet Preniqit nëse nuk doni ta ndryshoni kush është emri juaj.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Unë propozoj Enver Gashin.

Kryesuesi - A ka ndonjë propozim tjetër? Ne duhet të shohim edhe pjesën e kuotës gjinore a është e plotësuar.

Muhamet Preniqi - Unë propozoj znj. Linda Bekteshin.

Labinot Mirena - Unë propozoj nga LDK-ja, znj. Fitore Hashani.

Fitore Hashani - Para se të fillojmë me votimet unë falënderoj Labin për propozimin, por nuk jam dakord me propozimin, kështu që shefja e grupit le të jepë një propozim konkret.

Kryesuesi - A qëndron shefe e grupit propozimi që e dhatë në fillim?

Vlora Mjekiqi Kabashi - Nëse kuota gjinore është në rregull atëherë po.

Kryesuesi - Atëherë i rilexoj edhe një herë komplet 9 propozimet që janë bërë. Fillimisht shkojmë me propozimet e para, nga Lëvizja Vetëvendosje është Mervete Shala dhe Arbenita Pllana, nga LDK propozimi i parë është Muhamet Preniqi dhe Enver Gashi, pastaj tek komunitetet, nga komuniteti serb është Goran Dancetovic, nga komuniteti rom është Avdyl Mustafa, nga komuniteti boshnjak është Sanela Makcic, nga komuniteti ashkali është Faton Beka dhe nga komuniteti egjiptian është Haki Abazi. Fillimisht shkojmë me këtë përbërje kush është për?

(Kërkohet sqarim nga grupi parlamentar LDK se kush duhet të votohet)

Kryesuesi - Përbërja është prej 9 anëtarëve, LVV i ka 2 anëtar, LDK i ka 2 anëtar, Lista Serbe e ka 1 anëtar dhe 4 komunitetet e tjera e kanë nga 1 anëtar.

Linda Bekteshi - Pyeti se a zëvendësohet Muhamet Preniqi me dikënd apo shkojnë të dy të LDK-së.

Kryesuesi - Përgjegjet se të dy shkojnë të LDK-së, fillimisht propozimet e para janë prej grupit te juaj z.Enveri dhe z.Muhameti.

Goran Dancetovic - Nuk të kuptova mirë nga ajo që the, do të thotë që qytetarët që ishin këtu në takim, rezulton se erdhën pa nevojë për të zgjedhur anëtarin e tyre, do të ishte mosmirënjohje ndaj tyre nëse unë do të isha anëtar i Komitetit dhe jo përfaqësuesi që ata zgjedhën, do të tërhiqesha nëse do të ishte me ligj se unë te isha anëtar i zgjedhur nga komuniteti.

Kryesuesi - Ashtu siç e ceka në fillim ne kemi marrë sqarim nga MAPL-ja, ata na kanë thënë që shumica duhet të jenë përfaqësues të Kuvendit. Duke qenë se Lista Serbe ka përfaqësues në Kuvend, nuk mund të ketë përfaqësim të dyfishtë, edhe të zgjedhur atë ditë që kanë qenë këtu, për dallim me komunitetet e tjera që nuk kanë përfaqësues në Kuvend. Ky është arsyeimi nuk ka asnjë gjë diskriminuese, kështu është pjesa ligjore.

Goran Dancetovic - Të kuptoj, por sipas Nenit 62 të Statutit të Komunës, Komiteti për komunitete përfshin shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit komunal, pra 5 këshilltarë, nëse pajtohesh që 5 këshilltarë të jenë nga VV, LDK dhe AAK, dhe nuk duhet të ketë asnjë anëtar nga Kuvendi i SL përveç anëtarit të zgjedhur.

Kryesuesi - Unë ju kuptoj por në fillim e shpjegua këtë punë edhe për çështjen e ndërrimit të juaj, ju nuk mund të jeni edhe në Komitetin për Komunitete edhe të jeni zëvendës kryesues i Kuvendit. Kështu që ne e shpjegua prej fillimit në këtë përbërje, vetëm kjo mundësi na është dhënë, dy përfaqësues nga LVV dy

përfaqësues nga LDK dhe nga 1 përfaqësues nga Lista Serbe si dhe 4 përfaqësues tjerë nga komunitetet e tjera. Nekemi biseduar me MAPL-në dhe nuk mund të kemi ndryshime në këtë fushë. Kështu që duke qenë nga 9 anëtarë i kemi 3 emra të grave, kisha kërkuar ndihmën e znj. Vlora se a mund të procedojmë tutje, a është përfaqësimi i duhur gjinor?

Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesues, sa i përket anëtarëve të Kuvendit i ke 3 me 2 që i bien 5 edhe Ligji e parashehë që duhet me qenë 5 anëtarë të Kuvendit e 4 nga jashtë, kështu që 9 i ke mirë.

Kryesuesi - Te propozimet tek anëtarët e Kuvendit janë 5 ndërsa janë 3 gra ne fakt 2 gra, kështu që mund të procedojmë me këtë, edhe një herë i lexojmë emrat, vetëm nëse LDK dëshiron të ndryshoj propozimin, që ndonjëri nga emrat të jetë i gjinisë femërore.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Kryesues vazhdo me propozimin e parë unë mendoj që është në rregullë.

Kryesuesi - Shkojmë me votimin e parë siç i lexuam emrat nga Lëvizja Vetëvendosje është Mervete Shala dhe Arbenita Pllana, nga LDK është Muhamet Preniqi dhe Enver Gashi, pastaj tek komunitetet, nga komuniteti serb është Goran Dancetovic, nga komuniteti rom është Abdyl Mustafa, nga komuniteti boshnjak është Sanela Makcic, nga komuniteti ashkali është Faton Beka dhe nga komuniteti egjiptian është Haki Abazi.

(Kërkohej përsëri sqarim sa i përket çështjes së Dancetovicit nga ana e Enver Gashit

Kryetari - E kemi një problem me grupin parlamentar të LDK-së, i kemi 3 propozime dhe është e drejtë është parim me votue edhe për propozimin e parë ku është Muhameti dhe Enveri edhe për propozimin e dytë ku është e përfshirë edhe Linda Bekteshi, kështu që është mirë me vendos Kuvendi se a po duan Lindën dhe Muhametin apo dojnë Enverin dhe Muhametin.

Kryesuesi - Para se të kalojmë tek votimi i përgjithshëm, shkojmë tek votimi për përfaqësuesit e LDK-së. Propozimi i parë është Mervete Shala, Arbenita Pllana, Muhamet Preniqi, Enver Gashi, Goran Dancetovic, Abdyl Mustafa, Sanela Makcic, Faton Beka dhe Haki Abazi, kush është për propozimin e parë votojmë tani.

Anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e parë votuan me 9 vota për dhe 9 vota kundër.

Kryesuesi - Për propozimin e dytë, në këtë rast kur votat janë të barabarta vota ime është e dyfishtë, do të thotë propozimi i parë nuk kalon, shkojmë me propozimin e dytë me këtë përbërje: Mervete Shala, Arbenita Pllana, Muhamet Preniqi, Linda Bekteshi, Goran Dancetovic, Abdyl Mustafa, Sanela Makcic, Faton Beka dhe Haki Abazi, kush është për këtë përbërje votojmë tani.

Anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e dytë votuan me 16 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë abstenim. për plotësimin e Komitetit për Komunitete.

Abdyrrahman Krasniqi - Unë veç po du me ju thënë që në demokraci vendos vota, herën e kaluar është folë për komunitete dhe janë marrë veprime me kërkesë të znj. Linda Bekteshi, e cila ka bërë edhe publikim gjëja ka pazare, d.m.th. pas një muaji kohë po delë që nuk ka pazare ka transparencë, ka demokraci ka vendimmarrje, unë kërkoj nga Linda që të del të kërkoj falje dhe të tërhiqet nga deklaratat, në të kundërtën edhe ne do të veprojmë dhe do të thërrasim edhe kryesinë e partisë me marrë veprime ndaj saj.

Linda Bekteshi - Në këtë rast ishte në mënyrë transparente dhe nuk ka ndonjë Pazar, kështu që shefja e grupit i propozoj dy emra dhe me shumicë të votave kalova unë, kështu që nuk është mirë me fol për pazare, faleminderit për votën që ma dhatë faleminderit edhe një herë.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Propozim vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal. Siç jeni të informuar ky Kuvend ka zgjedhë 3 anëtar të Kuvendit që janë marrë me planin e punës ka qenë Lendita Krasniqi, Burim Ismajli dhe Vlora Mjekiqi Kabashi, të cilët i falënderoj për punën e tyre dhe për angazhimin e tyre në raport. Me atë që kam parë raportin që është miratuar dhe është propozuar për miratim do të ketë 12 mbledhje të rregullta, do të ketë 12 mbledhje të KPF-së, 4 mbledhje solemne. Për dallim prej viteve të tjera në këtë vit do të jetë edhe një mbledhje shtesë solemne, data 28 nëntori.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Sa i përket planit të punës së Kuvendit Komunal nuk kam diçka të shtoj por vetëm do të doja të të falënderoj që e ke pa të rrugës me sjell komplet materialin me shqyrtuar për arsye sepse kam qenë në spital dhe kam pasur probleme shëndetësore. Faleminderit që e ke parë të rrugës me sjell komplet materialin, kam pasur kohë ta lexoj atje dhe për mua është gjithçka në rregull.

Kryesuesi - Faleminderit edhe juve, atëherë kush është për miratimin e Propozim vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Aprovimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DEFZH për Plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale me nr.01-060-01-9738-24, të dt.04.04.2024.

Kryesuesi - Para se të hap debat e ftoj Drejtorin e Financave të na jap një shpjegim për ndryshimet dhe kërkesat që kanë të bëjnë në lidhje me këtë pikë,

Besnik Krasniqi - Drejtoria e Financave kërkon Plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale me nr.01-060-01-9738-24, të dt.04.04.2024, dhe largimin e pikës 1.17 nga neni 10 të Rregullores Komunale ku shkruan Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave fizik, propozohet largimi i pikës së Rregullores të cekur më lartë që e parashehë pagesën në vlerë 10 euro. Qëllimi i kësaj kërkesë është lehtësimi i qasjes së qytetarëve në shërbimet komunale, dhe eliminimi i barrierave financiare që mund ti prekë direkt në mirëqenien e qytetarit. Heqja e kësaj takse do të inkurajoj bashkëpunimin në mes të qytetarëve dhe institucioneve komunale, si dhe do të rritë transparencën.

Kryesuesi - Para se të hapi debat, dua të japë një shpjegim sepse kam pyetur dhe unë gojarisht në lidhje me këtë çështje. Kjo Rregullore në faqe 57 shtojca dy (2) pika tetëmbëdhjetë (18), kërkon që personat që raportojnë ndonjë parregullësi qoftë në ndërtim qoftë diçka kërkon që ai person që vjen të raportoj, ju duhet me paguar 10 euro për hapjen e atij raportimi, Drejtoria e ka parë të rëndësishme për të pasur transparencën dhe për ta parë njerëzit me ardhë dhe me i shpreh ndonjë gjë të keqe, apo fenomenet e këqija që ndodhin me heqë këtë pikë, mirëpo e kisha kthyer edhe njëherë fjalën te drejtori çka propozoni të hiqni si tërësi, ta bëni çmimin zero apo ndonjë çmim tjetër.

Besnik Krasniqi - Ne kërkojmë të heqim krejt, të jetë me çmim zero.

Fjolla Nasufi - Ne si grup e mbështesim këtë propozim të drejtorit.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Ja kaloj fjalën znj.Fitore Hashani.

Fitore Hashani - Derisa po flasim për Rregulloren për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha paralel me këtë ndryshimin që e keni sjellë në Kuvend, Kryetari i Komunës i ka nxjerrë disa vendime përveç Ligjit korrespondojnë edhe me Rregulloren në fuqi. Meqenëse dhe Drejtoria duke e pasur parasysh që e kanë sjellë për draft ne do t'iu japim mandej nëse veç se do aprovohet kjo, por mos të jetë kjo vetëm një pikë si pikë reference për me u largu si edhe po e cekni pikën në faqen 57 pikën 1.17. Kjo nga fakti se në bazë të rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe të Jashtëm edhe pse as dy vite nuk ka që është rregulluar kjo Rregullore ka pësuar disa ndryshime të ligjeve në fuqi sidomos tek Ligji për Financa dhe Ligji i Tarifave dhe Gjjobave në Ministrinë gjetëse, kështu që obligohemi që nëse, bëjmë draft ose plotësim ndryshim të kësaj Rregulloreje obligohet Drejtoria të na i sjellë më detajisht të gjitha ato atakime ku do ti ketë kjo Rregullore, ashtu që të ketë jetëgjatësinë e saj më afatgjatë. Përndryshe sa i përket kësaj pike në fjalë edhe atëherë e kemi diskutuar të hiqet do të thotë pajtohem.

Kryesuesi- Faleminderit shumë, Zoti Preniqi.

Muhamet Preniqi - Kërkoj një pauzë sepse jemi lodhur nëse kemi mundësi.

Kryesuesi - Fillimisht në lidhje me pikën kemi propozimin për një pikë të saktë edhe kur kemi qenë në pozicione të ndryshme ne kemi cekë se ka kjo Rregullore pajtohem me ju plotësisht, mirëpo kësaj radhe po e bëjmë miratimin e propozimit çka na ka ardhë. Kjo, nuk do të thotë se është propozimi i fundit, ne përsëri mundemi me hapë si Rregullore komplet dhe tani me parë, krejt çka mundemi me bë ndryshime por atëherë do të duhet me dalë në debat publik dhe merrë kohë pak më shumë.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Nëse më lejohet vetëm një rekomandim sa i përket plotësim-ndryshimeve të Rregulloreve sepse kam pasur edhe vetë nga e kaluara është mirë çdo pikë nën që ndryshohet sado i vogël

që të jetë në Rregullore, të kalohet përmes Debatit Publik për shkak të përformancës.

Kryesuesi - Unë ju kuptoj në lidhje me këtë pikë vetëm se kam marrë përgjigje prej MAPL-së dhe më kanë thënë që duke e marrë parasysh që është vetëm një ndryshim i vogël në këtë rast mundet me u procedue tutje. Megjithatë ne grupet e përbashkëta do të punojmë këtë punë dhe do ta ndryshojmë çka do që ka nevojë, mirëpo pas mbledhjes së të gjitha informacioneve në lidhje me këtë Rregullore.

Kryetari - Unë konsideroj që çdo qytetar që raporton një keqpërdorim duhet të shpërblehet nga Komuna e jo të dënohet nga Komuna, prandaj kjo ngarkesë që ka qenë për qytetarët, çdo raportim me gjobit me 10 euro qytetarin që po raporton është gabim trashanik. Ne mundemi edhe me dërguar në debat publik por kjo pikë është edhe e turpshme me dërguar në debat publik dhe përderisa unë do të jem Kryetar i Komunës kanë me u shpërblyer ata që i raportojnë keqpërdorimet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 për. 0 kundër, 0 abstenim morën Vendim për Plotësim ndryshimi i kërkuar nga Drejtoria e Financave për Rregulloren (KO) nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale me nr.01-060-01-9738-24, të dt.04.04.2024.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të kompanisë KRM "Pastrimi". Ky komision parashihet ti ketë 3 anëtarë d.m.th. Obiliqi merr pjesë në Komisionin e Aksionarëve me tre anëtarë, një anëtar propozohet nga Kryetari i Komunës, dhe dy anëtar janë përfaqësues të dy subjekteve politike që do t'iu takojnë njëri LVV dhe tjetri LDK. Fillimisht kërkojmë nga Kryetari të na jepë një propozim për përfaqësuesin e Ekzekutivit.

Kryetari - Propozimi i Ekzekutivit është Nënkryetari Berat Gashi.

Fjolla Nasufi - Nga LVV propozojmë z. Burim Ismaili.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Ne propozojmë z. Fidan Ahmeti.

Kryesuesi - Nga Lidhja Demokratike a ka ndonjë propozim tjetër?

Labinot Mirena - Unë propozoj kolegun tim nga LDK-ja, z. Abdyrrahman Krasniqi.

Kryesuesi - Atëherë fillimisht shkojmë me propozimet e para, Berat Gashi nga Ekzekutivi, Burim Ismaili nga LVV dhe Fidan Ahmeti nga LDK, kush është për këtë përbërje, votojmë tani.

Aëtarët e Kuvendit Komunal votuan për propozimin e parë me 7 vota për, 12 vota kundër dhe 2 vota abstenim, ndërsa për e propozimin e dytë z.Berat Gashi nga Ekzekutivi, z.Burim Ismaili nga LVV dhe z. Avdyrrahman Krasniqi nga LDK-ja, votuan me 13 vota për, 5 vota kundër dhe 3 vota abstenim dhe sipas propozimit të dytë morën Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve KRM "Pastrimi".

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti Raportin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2025. Ashtu siç e cekëm tek Raportet tjera paraprake ne kemi dashur me bë një raport për arsyen sepse Institucionet duhet të kenë vazhdimësi, për çka e falënderoj edhe legjislaturën e kaluar kolegët, edhe për gjithë punët që janë bërë. Brenda kësaj kohe janë mbajtur 11 mbledhje të rregullta, 2 mbledhje të jashtëzakonshme, dhe tri mbledhje solemne, përveç asaj janë marrë vendime të ndryshme dhe një Rregullore që ka të bëjë me Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga MAPL-ja për vendimin e nxjerrë për shpalljen e pronave publike në Ueb faqen e Komunës, te pronat publike, tek lista e veçante e pronave publike edhe pse në propozim vendim kanë qenë të parapara detajet dhe të gjitha tjerat, Ministria ka gjetë që është dashtë Lista e Përgjithshme e Pronave me iu shtua tri kolona në të cilat kolona shkruan qëllimi, destinimi dhe periudha e shfrytëzimit që parashihet me u dënë për vitin 2026, Nuk ka asnjë ndryshim tjetër është kërkuar vetëm që lista e veçante sikur që shkruan në propozim vendim të shkruhen edhe në listë të shtohen edhe tri kolona, këtë ndryshim na është kërkuar me bë.

Fjolla Nasufi - Jemi dakord me këtë pikë të rendit të ditës.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Nuk kemi asgjë sa i përket kësaj pike.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 për morën Vendim për aprovimin e Propozimvendimit nr.02-020-01-38434-25, të dt.22.12.2025 Publikimin në Faqen Zyrtare të Komunës të Listës së Përgjithshme të Pronës së Paluajtshme të Komunës të dhënies në shfrytëzim dhe të Listës së veqantë e pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.

Kryesuesi – E kemi kërkesën e Florim Kelmendit i cili kërkon nga Kuvendi Komunal në Obiliq që të mundësoj plotësim ndryshimin e Kontratës me numër 02/420 të datës 14.05.2021 e cila është në emër të "Nic Home" SHPK, e që të kaloj në emër të "Nic Tec" LLC, ku pronar i dy bizneseve thotë që është i njëjti person Florim Kelmendi, Tek kjo çështja e kërkesave unë kam filluar një ndryshim të vogël, çdo kërkesë që po vjen në Kuvend, unë po e konstatoj saktë për cilën Drejtori është dhe pa pritë derisa mbahet seanca po e dërgojmë në Drejtorinë gjegjëse. Në këtë drejtim përgjigja e Drejtorisë së Urbanizimit është që kontrata në fjalë ka kaluar në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit në Kuvendin Komunal në përputhje me nenin 9 të Ligjit 06 L-092, ndërsa vlerësimi i ligjshmërisë është kryer nga MAPL, prandaj e vetmja mundësi ligjore për shqyrtimin e kërkesës suaj është procedimi i saj përmes Kuvendit Komunal përmes aneks kontratës apo vendim tjetër përkatës i cili duhet të jetë në përputhje me procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale.

Kryetari - Meqenëse me datën 14.05.2021, Komuna ka nënshkruar kontratë për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, ku i njëjti pronar, natyrisht i takon me dërguar në Kuvend edhe pse ka mundësi edhe Kryetari i Komunës me përfunduar këtë ndërrim, por unë do të doja që Kuvendi të vendos. Ne e dimë që janë dhënë shumë prona në shfrytëzim prandaj nuk jemi as me i dëmtuar as me i blloku bizneset dhe unë mendoj që nuk ka diçka të jashtëligjshme që ne jemi duke e proceduar këtu.

Kryesuesi - Kryetar me aq sa e kuptoj ju kërkon miratimin nga Kuvendi Komunal që ju si Ekzekutiv ta bëni këtë ndryshim të paraparë.

Fjolla Nasufi - Jemi dakord që të vazhdohet tutje me këtë kërkesë.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Fjalën ja kaloj znj. Fitore Hashani.

Fitore Hashani - Kuvendi propozon apo miraton sepse Ligji i Pronave cakton qartë që kompetenca i takon drejtpërdrejtë Kryetarit, Kuvendi nëse, në këtë rast jep plotësim ndryshim të pronës apo me aneks kontratë një pronë apo parcele shtesë. Ndërsa sa i përket emërtimeve të bizneseve, ndërrimeve ose kodeve të ndryshme të bizneseve Drejtoria e Urbanizimit së bashku me Drejtorinë e Financave mund ta kryejnë këtë punë. Pra, miratimin e keni nga Kuvendi sepse asgjë nuk është trashanike apo diçka e gabueshme kështu që ju falënderojmë për transparencën, por është kompetencë e plotë e këtyre dy Drejtorive dhe fundja është edhe punë e tyre.

Kryesuesi - E thashë edhe më herët që nëse qytetarët bëjnë kërkesë për Kuvendin Komunal ne po dojmë të bëjmë një zakon, që secili që bën një kërkesë edhe pse kërkesa nuk ka të bëjë me ne, të paktën një informim kemi për t'ia dhënë palës. Kërkesa e Kryetarit në lidhje me miratimin mua më duket që vetëm e rritë më shumë transparencën dhe besimin dhe nuk është asgjë keq që ne si Kuvend i japim kompetencë Kryetarit që të bëjmë këtë ndryshim dhe Drejtorive gjegjëse.

Abdyrrahman Krasniqi - Unë mendoj se edhe ne si Kuvend por edhe Ekzekutivi duhet të punojmë dhe t'ua lehtësojmë veprimtarinë bizneseve. Ne e dimë që me çfarë sfidash po ballafaqohen bizneset në këto kohë, d.m.th. konkurrenca globale kështu që e mirëpres çdo plotësim ndryshim meqë pronari nuk ndryshon, dhe mendoj pse duhet të jemi bllokues të biznesit të caktuar, edhe pse unë nuk po e njohë personalisht, por mendoj që si Kuvend por edhe si Komunë duhet të krijojmë kushte dhe t'i mundësojmë ti zhvillojnë veprimtaritë e tyre. Kontratat janë për 99 vite dhe për 99 vite munden me pasë plotësim- ndryshime edhe ndryshim të veprimtarive.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për dhe 2 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e kërkesës nga Florim Kelmendi "Nic Home" SH.P.K. për plotësim ndryshimin e kontratës me nr.II/420 të dt.14.05.2021 e cila është në emër të Nic Home SH.P.K. të kaloj në emër të "Nic Tech" LLC pronar i të dy bizneseve në Milloshevë.

Kryesuesi - Kemi një kërkesë tjetër nga OVL- UÇK, të cilët kërkojnë mbështetje për një aktivitet të përvitshëm që ata e bëjnë dhe zakonisht kishin pasur kërkesë për mbështetje nga dy Komuna, prej Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Obiliqit, për aktivitetin për nder të përvjetorit të UÇK-së. Ky aktivitet zakonisht mbahet me 7 Mars, dhe kanë kërkuar që këtë aktivitet ta zhvendosin me 17 Shkurt në Ditën e Pavarësisë së Kosovës. Ky aktivitet do të mbahet në Çyçavicë tek tri shkronjat e UÇK-së që janë të vendosura atje. Kërkesa ka qenë e pozicionuar në dy drejtime, pjesa e parë kërkojnë mjete financiare për mbështetje për ushqime dhe pije gjatë asaj kohe, për të cilën e kemi dërguar një kërkesë tek Drejtoria e Financave dhe që na kanë kthyer një përgjigje pozitive. Ndërsa kërkesa e dytë ka pasur të bëjë me diçka që ne nuk kemi pasur mundësi të realizojmë, sigurimi i shatorëve, tavolinave dhe karrigave, që për këtë kërkesë unë i'u kam drejtuar edhe Ministrisë së Mbrojtjes, e cila është duke e shqyrtuar mundësimin e kësaj kërkesë. Për pjesën e buxhetit që e kanë kërkuar unë i'a kisha kaluar fjalën Drejtorit të Financave.

Besnik Krasniqi - Pas shqyrtimit të kërkesës së OVL-së, dega Kastriot ne konsiderojmë që kërkesa ka plotësuar kushtet për të vazhduar tutje për subvencionim, kështu që nuk kemi diçka tjetër për të shtuar.

Fitore Hashani - Drejtori e tha që ka buxhet dhe jena në rregullë, kategoria e subvencioneve, mënyra e realizimit të këtyre mjeteve, vendim i drejtpërdrejtë i Kryetarit, thirrje publike deri në afatin ku duhet apo cila sa i përket mjeteve. Ndërsa sa i përket komplet aktivitetit nëse mbahet nën patronatin nën mbështetje të OVL-së të UÇK-së nën patronatin e Kryetarit besoj që është Komisioni në Drejtorinë e Kulturës i cili mund të na tregoj ma detajisht për mbështetjen e Kuvendit dhe konkretisht të të gjithë ne asambleistëve, sepse korrespondon me dy data të rëndësishme që është "17 Shkurti" Pavarësia e Kosovës dhe njëkohësisht është edhe Protesta apo Marshi në emër të UÇK-së, dhe të gjithë atyre që padrejtësisht po mbahen në Hagë. Mendoj se duhet të ketë shumë vëmendje ky aktivitet.

Besnik Krasniqi - Unë mendoj që kjo kërkesë duhet të votohet njëkohësisht edhe të përcaktohet vlera. Kuvendi mundet me votue, është shumë në rregullë.

Vlora Mjekiqi Kabash i- Paraprakisht në qoftëse kërkesa votohet dhe merret vendim në Kuvend është e rregulluar me ligj që duhet të specifikohen mjetet sepse përndryshe vendimi do të kthehet.

Kryetari - Specifikimi i mjeteve dihet prej subvencioneve është vlera 2000 euro, nuk është ndonjë vlerë mirëpo vazhdimisht OVL-të e UÇK-së e kanë marrë, korrespondimin e datave qoftë me pavarësi qoftë me protestë. E dijnë OVL-të e UÇK-së me mirë se unë të paktën, ata e dinë ata e kanë kërkuar me mbajtje manifestimin dhe e kanë kërkuar sepse viteve të tjera e kanë mbajtur me 7 Mars për nder të Epopesë të Prekazit. Tani e kanë vendosur me 17 Shkurt për arsye të Pavarësisë së Kosovës, për arsye sepse është Ramazan me 7 Mars, kjo është arsyeja nuk është diçka tragjike dhe ne ua kem borxh me ju ndihmuar aq sa kemi mundësi.

Kryesuesi - Kemi një kërkesë tjetër që e ka sjellë Muhamet Preniqi në emër të qytetarëve dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara me autizëm dhe me Sindromin down, duke kërkuar veprim të menjëhershëm dhe të matshëm institucional. Kuvendi Komunal ka obligim të ligjshëm dhe moral të bëjë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ata kërkojnë ndarje urgjente të buxhetit të dedikuar për fëmijët me autizëm dhe Sindromin Down, krijimin dhe funksionalizimin e qendrave komunale për terapi, rehabilitim dhe mbështetje psikosociale, arsim inkluziv me asistencë profesionale dhe staf të trajnuar në institucionet arsimore, transparencë dhe raportim publik. Unë kam kërkuar përgjigje nga Drejtoria e Financave dhe nga Drejtoria e Shëndetësisë, të dy palët na kanë dhënë një përgjigje që janë duke e shikuar gjendjen sepse pushteti vetëm sa ka ndryshuar dhe janë duke e bërë të pamundurën që secila kategori me pasë trajtimin e duhur.

Fitore Hashani - Edhe kjo kërkesë si dy kërkesat e tjera paraprake ju vetëm se e potencuat që i takon kategorisë së Drejtorisë së Financave, po ashtu dhe Drejtorisë së Shëndetësisë në këtë rast tek Zyra për Mirëqenie Sociale. Prandaj nga e kaluara ashtu kemi vepruar, nuk do të thotë që do të veproni ju por është shablloni i mirë dhe nuk kemi pasur asnjëherë gjetje në këtë fushë. Besoj që e keni rrugën e gatshme se si duhet të veproni në rastet e subvencionimit dhe kategorive gjithë përfshirje vetëm se ka për këtë kategori të fëmijëve sidomos ka bashkëpunim në mes të Drejtorisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës sa i përket aktiviteteve që i mbajnë dhe përfshihen sepse siç e dijmë janë kategori shumë të

ndjeshme dhe i takon gjithë përfshirja në këto fusha e përkatësisht në këto Drejtori, kështu që ndihma e Kuvendit do të jetë e pa diskutueshme.

Goran Dancetovic - Fëmijët janë shtresa më e ndjeshme e shoqërisë, e sidomos fëmijët me nevoja të veçanta. Sipas raportit financiar, Komuna ka një buxhet të mirë dhe mendoj se këta fëmijë meritojnë një ambient ku mund të kalojnë kohë, që të kenë një ndikim profesional në përmirësimin e shëndetit të tyre mendor. Mendoj se kjo kërkesë është e justifikuar, dhe se duhet të kryhen konsultime me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Arsimit, për të parë se cila ndihmë është më e përshtatshme, cilët staf profesional janë ndihmësit, po besoj defnologë dhe në të ardhmen duhet të parashikohet ndërtimi i një qendre, në mënyrë që këta fëmijë të marrin ndihmë të përshtatshme..

Kryesuesi - E cekëm qysh në fillim e kemi vullnetin dhe jemi duke shqyrtuar mundësitë dhe duke i përdorur praktikat paraprake që kanë qenë të mira, por gjithsesi edhe gjërat e reja që të gjitha kategoritë të ndjenjës përfaqësimin e mirë edhe të gjitha kategoritë të marrin ndihmën që i takon. Ne do të bëjmë të pamundurën për këto kërkesa të këtilla, që mos të kemi kërkesa të ngjashme herave të tjera.

Kryetari - Siç po shihet kërkesa është me vend, mirëpo siç e tha kryesuesi nuk është një kërkesë specifike që po kërkohet shumë e caktuar ose një projekt i caktuar. Natyrisht që i institucioni i Komunës edhe qeverisjet e mëhershme gjithmonë janë përkujdesur, kurrë nuk është e mjaftueshme dhe sigurisht ne si qeverisje do të bëjmë të pamundurën që të kujdesemi aq më mirë dhe aq sa dimë për këto kategori. Natyrisht që gjendja nuk është mjaftueshëm e mirë, mirëpo ne do të bëjmë përpjekje si qeverisje dhe e keni edhe mbështetjen e Kuvendit Komunal, për çdo nismë drejtuar këtyre kategorive që janë shumë të rëndësishme për ne.

Kryesuesi - Në bazë të nenit 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ky Kuvend duhet të zgjedhë edhe Nënkryetarin e Komunës për Komunitete, andaj Kryetar pasi që edhe ka kaluar edhe afati 30 ditësh që e ke pasur obligim, ju kisha lutur ta plotësoni këtë obligim, nëse veç e keni një propozim ta propozojmë edhe të shkojmë para.

Kryetari - Unë kam një propozim që sigurisht se do të jetë përfaqësuesi i qytetarëve serbë dhe unë i besoj këtij personi. Prandaj kërkoj mbështetjen e secilit prej juve e në veçanti të asambleistëve që përfaqësojnë komunitetin serbë, që ta votojnë personin që unë i besoj dhe personin që unë do të mundohem ti shtyjë përpara proceset dhe politikat tona që ne i kem. Personi është z.Stevan Radosavljevic, andaj kërkoj nga ju të votohet ky person.

Goran Dancetovic - Mendoj se propozimi nuk është i justifikuar duke pasur parasysh se dje pamë njoftimin e Gjykatës Kushtetuese se zgjedhja e z. Rasic në Parlamentin e Kosovës nuk ishte kushtetuese. Unë bëj një paralele midis asaj zgjedhjeje dhe këtij propozimi tuajin, ju propozoni një kandidat që është anëtar i partisë së z. Rasic, e cila nuk kishte listë në zgjedhjet lokale dhe nuk ka këshilltarë në këto zgjedhje. Për këtë çështje, unë propozoj konsultime shtesë, në mënyrë që të kemi një zgjidhje të përbashkët dhe ta sjellim këtë institucion më afër qytetarëve.

Kryetari - Për ata që nuk e kuptuan vetëm dy fjalë po i them në atë kuptimin që e tha zotëriu. Fillimisht kisha kërkuar prej Kuvendit me bë rregullimin e dëgjuesëve në mënyrë më të shpejtë të mundshme sepse nuk ka kuptim. Zotëria tha që që unë e propozova nuk ka pasë subjekt në zgjedhjet lokale dhe nuk është marrë me zgjedhjet lokale. Unë propozoj atë që unë i besoj, pra ky është propozimi i imi, mbase dikush edhe shumëkush prej juve nuk mund ti pëlqej, e pëlqimi dhe mospëlqimi shkon me votën pro apo kundër. Unë kam nevojë dhe ma lejon kushtetuta që ta propozoj një person që unë i besoj. Unë mendoj që me Stevanin mund ti shtyjë proceset përpara politikat e mija, pra kaq është shumë e shkurtë është kush dëshiron e voton kush dëshiron nuk e voton.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryetar, unë pajtohem shumë me arsyetimin e juaj, fillimisht vetëm kërkoj të mos ketë një propozim të Listës Srbska e cila nuk e njeh Republikën e Kosovës. Fillimisht këta duhet të vetëdijësohen dhe të njohin Institucionin e Kosovës, pastaj të synojnë të shërbejnë në institucione dhe Republikë të Kosovës, sepse këta po veprojnë të kundërtën d.m.th. kur po është Shtetësia e Kosovës dhe statusi i tyre dhe deklarata e tyre janë që Kosova nuk po dua me përmendë, ndërsa kur po është puna te

privilegjet dhe te pozicionet po kërkojnë me marrë përgjegjësi. Unë mendoj që ne si shtet duhet të kemi parasysh dhe të mos bëjmë lëshime në këtë drejtim.

Fitore Hashani - Vetëm doja disa pyetje se kam idenë kush është dhe nuk e kemi pasur njoftimin që do të jetë temë diskutimi Nënkrjetari. Mirë që e ceku Kryetari që nuk ka të bëjë me zgjedhjet dhe subjektet politike, a ka mundësi një CV të këtij zotëriu, ta dimë kush është, si është që po e cekë disa herë Kryetari shkarazi nëpër fjalitë e veta që i beson, as nuk po e paragjykoj pse po i beson. Mirëpo, a mund ta dimë një element se kush është ky lloj elementi që e kemi këtë lloj të besimit me Kryetarit dhe Nënkrjetarin për komunitete e pa kaluar deri te zgjedhjet e fundit dhe votat e Kryetarit në 460. Më duket Kryetar është kështu, edhe pse jam mirë me shifra, nuk e di a e kam mbajtur mirë mend, mos do të jetë ndonjë lloj pazari siç po thotë edhe Enveri mandej po ta definojmë më saktë siç po thotë edhe Mani ta thërrasim në transparencë, ta dimë saktë nga është besimi në mes të Kryetarit dhe Nënkrjetarit dhe ne e votojmë mandej pa problem. Nëse ka fakt dhe arsye që mund ti besojmë Kryetarit sepse fundja besoj që lëndët dhe puna e tij e përbashkët me Kryetarin ndoshta në një të ardhme do të vijë edhe në Kuvend.

Enver Gashi - Unë sa jam i informuar dhe sa e kam kuptuar mbledhjen e kaluar Kryetari ka thënë që është kompetencë e Kryetarit me caktuar drejtpërdrejtë dhe nuk ka nevojë në Kuvend. Tash erdhi te Kuvendi, atëherë Kryetar dhe ju të nderuar unë nuk jam për ta votuar kur nuk e di kush është sepse së pari, është mirë që Kryetari me na jepë një historiat kush është ai njeri pavarësisht partisë, po e plotësoj parafolësen time, çka ka të kryer, ku jeton, a ka bo ndonjë veprimtarie ndonjëherë, një historiat të shkurtë.

Goran Dancetovic - Nuk do të doja të komentoja deklaratat e kolegëve të mi në lidhje me disa nga qëndrimet që i atribuohen partisë tonë. Mendoj se me aktin e formimit të Komunave lokale në territorin e Kosovës, kemi treguar se respektojmë Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunave, si shembull do të bëjë një paralele me Komunën e Graçanicës. Ata kanë shumicë absolute në Komunën e Graçanicës SL. Në Komunën e Graçanicës të gjitha partitë shqiptare u bashkuan për të formuar Aleancën Shqiptare, dhe pa një koalicion me SL, Leutrim Ajeti u emërua Nënkrjetar Komune. Ajo që unë e respektoj sepse shqiptarët nga Komuna e Graçanicës i besuan dhe ia dhanë si bartës të listës, do ta përdorte atë për të përgëzuar Kryetarin e Komunes z.Novak Zivic për zbatimin e ligjit dhe demokracisë, dhe për të përgëzuar Leutrim Ajetin për këtë pozicion.

Kryesuesi - Zotëria e tërhoqi një paralele që Komunitat ku janë me shumicë serbe funksionojnë sipas Ligjeve të Kosovës. Gjithashtu në Graçanicë këta kanë zgjedhë personin që e ka propozuar shumica shqiptare, e kanë përzgjedhë pse nuk janë në vija politike të njëjta dhe ky donë që çështjen e njëjtë ta bëjë edhe në Obiliq.

Kryetari - Përfaqësuesi nga komuniteti serb Goran Dancetovic i mori disa shembuj se si e kanë bërë atje Nënkrjetarin Komuna e Graçanicës apo ndonjë Komunë tjetër. Mbase mund të ketë ndodhë edhe ashtu, por për mua nuk është e rëndësishme ajo punë. Për mua është e rëndësishme personave që unë ju besoj e në fakt unë pajtohem 100% me asambleistin zoti Krasniqi i cili thotë që nuk duhet të jetë Nënkrjetar një person i cili nuk i njehë apo nuk i pranon institucionet e Republikës së Kosovës. Ai është pjesë e institucioneve, ka qenë pjesë e institucioneve z.Stevan Radosavljevic ka përfunduar Fakultetin për Siguri dhe Shëndet në Punë, e ka të përfunduar në Leposavic, ndërsa unë mendoj dhe e them përsëri se është një bashkëpunëtor i mirë dhe është një djalë i mirë që unë mund të kem një sukses në politikat e mija. Unë kërkoj nga Lista Serbe në këtë rast që duhet ta dinë një herë e përgjithmonë që zgjedhjet kanë përfunduar dhe është bërë një ndryshim në qeverisjen në Obiliq, prandaj unë do të punoj me ata që ju besoj. Shkurt, Zoti Goran Dancetovic ke humbë në zgjedhje dhe kjo nuk mund të bëjë ty Nënkrjetar Komune.

Bajram Hashani - Krejtë në rregull dëshira dhe vullneti është, vetëm mos ta shkelim ligjin, e po na e kthen pas 1 muaji sepse nëse është në rregull me ligjin ne gjithmonë jemi. Mos të shesim patriotizëm me na vënë para një akti seriozisht të palakmueshëm, jo i Listës Serbe ne e dimë të gjithë çka është Lista Serbe, por përderisa është certifikuar dhe e legalizuar, mos na lini në pozitë të palakmueshme. Sqaroni gjërat qysh duhet krejtë është në rregull, vetëm të sqarohen gjërat në detaje Kryetar. Mos na vëni ne lajthitje me këto gjëra dhe pas 1 muaji me na ardhë i jashtëligjshëm, as nuk e dimë kush është as nuk e kemi parë, nuk e njohim seriozisht nuk e dimë, unë për vete po flas.

Kryetari - Propozimi bëhet për Nënkryetarin e komuniteteve bëhet nga vet Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Komunës ka të drejtë çdo qytetar serbë me propozue për kandidat për Nënkryetar të Komunës për komunitete. Këtë e thotë ligji dhe nuk po e them unë. Unë e kam propozuar një person, është pjesë e Asamblesë dhe është e drejtë Lista Serbe nuk po pajtohet me atë person, pra Lista Serbe sipas Ligjit natyrisht që një pjesë e tyre do të duhet të jepte votën për atë person me qenë i ligjshëm emërimi. Ajo është në domenin e Listës Serbe nëse vendos ta voton këtë person apo jo kaq. Pra Lista Serbe vendos a me pasë Nënkryetar serb apo jo, unë vendos kënd ta marrë, a e vendos z.Stevan, apo me marrë Goranin.

Kryesuesi - Është kompetencë e Kryetarit me propozue, është kompetencë e Kuvendit Komunal me votuar, të gjitha kërkesat paraprake ne i hedhim më parë në votim.

Fitore Hashani - Unë po pajtohem plotësisht e sidomos me sqarimin që na bëri Abdylrahmani që nuk i takon Lisës Srbska, as nuk i takoj gjeneratës me luajt rolin e patriotizmit se kam lindur në 1882, kështu që në protesta kam qenë kur ka qenë në flakë Kosova. Për këtë arsye për ata që e kanë dhënë primatin e atdheadashurisë, ne jemi ta zhvillojmë vendin këtu, nëse është kompetencë me propozue Kryetari, Nënkryetarin në rregullë, e dëgjuam propozimin, i dhamë të drejtat tona dhe i kërkuam të drejtat tona, kush është personi që na propozoj Kryetari, nuk ka asgjë të keqe këtu. Unë do të abstenoj sepse unë nuk e di se çfarë po votoj dhe kush është personi, sikurse të më thotë Kryetari tash që e ka pasur kompetencën e plotë ta emëroj Nënkryetarin e komunitetit shqiptar, e ka emëruar. Në rregull do të njihemi me Nënkryetarin e Komunës, gjatë rrugës dhe gjatë debateve që do t'i kemi në Kuvend, jo të njëjtën gjë do ta kem edhe me këtë komunitet, megjithatë Kryetar paguhet dhe pagën e tij do ta marrë me taksa pagim apo jo. Atëherë për këtë arsye pyeta kush është ky personi që ju e propozoni për Nënkryetar të komunitetit serb. Nëse s'kemi pasur të drejtë kërkojmë falje, po besoj që kemi pasur të drejtë dhe e thamë në mënyrë shumë demokratike.

Abdylrahman Krasniqi - Unë vetëm po e plotësoj Drejtoreshën, nuk ka asgjë të keqe me dashtë vendin përkundrazi ne duhet ti mësojmë edhe gjeneratat e reja me dashtë vendin. Ne i respektojmë çlirimtarët por nuk do të thotë që vetëm ata e duan vendin, respekt që na kanë çliruar por edhe ne e duam vendin, kështu çfarë mundë të bëjmë është të ju ftoj edhe juve të votojmë sepse ne e dimë që kandidatët e Listës Srbska nuk po e pranojnë këtë vend, kështu që jo me abstenuar drejtoreshë, por ta votojmë.

Fitore Hashani – Pyes, a na i njehë ky personi që e keni propozuar vendin Kryetar, cilit komunitet serb i takon, d.m.th. Serbia a na ka njohtë neve, dhe komuniteti serbë që jeton në Kosovë po na njohin? Vetëm kaq një sqarim dhe unë e votoj.

Labino Mirena - Po çuditë po kërkojnë CV për Nënkryetarin e ri sepse unë e ti z.Sami dhe disa këtu që kemi qenë që e kemi përsëritur mandatin e asambleistit, le të më tregojnë këta kolegët e mijë se çfarë CV-je kryesues e kemi marrë të ish Nënkryetarit të kaluar. Ne nuk kemi pasur CV që i ka sjellë Kuvendit, nuk kemi pasur kemi dëgjuar më shumë prej mediave, kështu që për mua është në rregullë dhe unë votoj pro.

Kryetari - Unë vetëm po i tregoj znj.Hashani, që po e dimë pse po bëni zhurmë nuk do të jetë më z.Slavisa Jakovljevic, e kam thënë edhe gjatë zgjedhjeve unë Kryetar e Slavisa Jakovljevic Nënkryetar asnjëherë. Shumë mirë e ka z. Mirena që CV kurrë nuk është shpalos në këtë Kuvend, prej vitit 2013 kur ai ka qenë Nënkryetar i një subjekti të caktuar. Pra unë e thashë edhe një herë Lista Serbe i ka humb këto zgjedhje për të qenë Nënkryetar prej Listës Serbe. Lista Serbe mundet me lënë Komunën e Obiliqit pa Nënkryetar të Komunës së Obiliqit, por asnjëherë nuk do të jetë Nënkryetari nga Lista Serbe.

Fitore Hashani- Nuk më intereson fare kush ka qenë Nënkryetar për komunitete, por më intereson se kush do të jetë.

Goran Dancetovic - Ka mjaftueshëm tension në sallë, sugjeroj që ta relaksojmë atmosferën, sepse unë vijë këtu si një unifikues i kolegëve të mi, sepse kur duhet të jetë dikush kundër, ju jeni të gjithë bashkë kundër nesh. Nuk do të komentoja për zgjedhjen e mëparshme të jakobinëve, disa nga këshilltarët e mëparshëm po kërkojnë një CV më parë, ndoshta kanë votuar, unë nuk kam votuar, nuk kam qenë këshilltar më parë, duhet ta kishin menduar atëherë. Meqë Kryetari i bashkisë tha se nuk mund të jem deputet i qytetarëve dhe nuk dua të jem, mora besimin e qytetarëve për të qenë këshilltar dhe do të jem përfaqësues i atyre qytetarëve. Mund të gjendet një zgjidhje kompromisi dhe jo një person anonim pa biografë, midis komunitetit serb, siç

sugjeroj Stevan Radosavljeviç. Sipas kushtetutës, është e drejta e Kryetarit të bashkisë të propozojë, dhe ne, si këshilltarë të komunitetit, të votojmë pro ose kundër atij propozimi.

Kryetari - Për ata që nuk e kuptuan e nuk patën përkthim unë po ua përkthej, por më vjen mirë që të dy grupet po bashkoheni kundër meje. Ne jemi të bashkuar kundër akteve që ju i bëni, që subjekti politik i juaji që i bënë, diskriminimi shantazhet që vetë popullatës serbe jeni duke ia bërë. Unë besoj këtu jam bashkë me Enverin, bashkë me LDK-në, bashkë me VV e me AAK-në, jemi bashkë, kundër atij shantazhi atij kërcënimi që po ja bëni komunitetit serbë. Prandaj po ju kërkoj me mirësjelljen më të madhe votoje përfaqësuesin nga komuniteti serbë, votoje për Nënkryetar të Komunës. Kaq.

Kryesuesi - Atëherë, është konsumuar ky debat propozimi i Kryetarit është për z.Stevan Radosavljevic, që sipas ligjit duhet të jetë shumica e Kuvendit plus shumica tjetër atëherë shkojmë me votim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për, 2 vota kundër dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Emërimin e z.Stevan Radosavljevic, Nënkryetar për Komunitete në Komunën e Obiliqit.

Pika 12 e rendit të ditës

Kryesuesi - I këshilloi asambleistët e rinjë që ti marrin llaptopët, dhe që të marrin pjesë në seanca.

Kryetari - Për nder të ditës së "17 Shkurtit" Ditës së Pavarësisë së Kosovës, unë kam një propozim dhe kërkoj nga Kuvendi Komunal të ma aprovoj këtë propozim tjetër, që veturën time që më takon mua si Kryetar i Komunës ta japë donacion për OVL-të e UÇK-së në Obiliq. Kërkoj mbështetjen tuaj, që kjo veturë të kalojë në pronësi të OVL-së së UÇK-së.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për morën Vendim Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës "17 Shkurti" vetura zyrtare e Kryetarit të Komunës të kalon në pronësi të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK-së).

Fidan Ahmeti - Kam dy pyetje për ju, kam pasur pyetje të shumta për transportin publik, a ka ndonjë ndryshim ndonjë proces që është në zhvillim e sipër në këtë pjesë. Ndërsa pyetja e dytë është direkt nga unë kam marrë miratimin prej Shoqatës Kërkim shpëtimit me hapë degën në Obiliq, degët tjera janë hap në qytete të tjera. E din rëndësinë e kësaj Shoqate Kryetar, prej kryesisë lartë, Bordit kam marrë miratimin vetëm dua të kem një takim zyrtar, miqësor me ty në raport me këtë kërkesë nëse ka mundësi.

Kryetari - Sa i përket pyetjes së parë, për transportin publik po jemi duke e detajuar një plan konkret, sigurisht puna dhe mënyra e subvencionimit do të vij edhe në Kuvend dhe do të bisedojmë gjerë e gjatë për këtë çështje dhe presim edhe propozimet secilit prej asambleistëve. Ne do të vijmë me një projekt konkret dhe të detajuar, të specifikuar shumë mirë, kështu që besoj që në seancën e ardhshme do ta kem në Kuvend. Ndërsa, tek pyetja e dytë fillimisht dua ti falënderoj Shoqatën e Kërkim Shpëtimit sepse me të vërtetë janë heronjtë të vërtetë dhe kanë qëndruar heronjtë të vërtetë në këto momente kur kanë qenë në krye të detyrës. Sa i përket degës së Shoqatës, çka do të varet prej neve, si Kryetar gjithmonë jam i gatshëm me i ndihmuar kësaj Shoqate atyre djemve, të cilët me të vërtetë janë për çdo lëvdatë.

Labinot Mirena - Kam një kërkesë për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Kadastrit, rruga e Llapit që e quajmë rrugën prej Obiliqit deri në Milloshevë, kam kërkesë për me ndryshue emrin e rrugës, është rrugë që frekuentohet jashtëzakonisht shumë që e lidhë Obiliqin me Milloshevën. Unë kisha propozuar që t'iu largohet emri i rrugës "Llapi" dhe ta ndërrojmë me emrin e dëshmorit të parë në Komunën e Obiliqit "Faik Tefik Mjeku" kisha pas dëshirë të dijë procedurat të cilat kërkohen që të ndryshohet ky emër.

Kryesuesi - Ti me siguri e din shumë mirë që ekziston një listë rezervë e emrave të miratuar dhe të cilën nuk mund të ndryshohet vazhdimisht, mirëpo këtë kërkesë do i'a kalojmë Drejtorisë. Unë jam i sigurtë që sot nuk mund t'iu japin një përgjegje, por në takimet tona të ardhshme jam i sigurtë se do të iu përgjigjem.

Bajram Hashani - Kemi një shqetësim në lidhje me mbeturinat, por besoj që jo vetëm unë por edhe të gjithë qytetarëve, me të vërtetë kohët e fundit, mbeturinat nuk janë duke u mbledhur në kohë të rregulltë, ndodhë që kalojnë tre javë dhe nuk vijnë ti marrin. Ky problem po ndodhë tash e sa kohë, mund të kalojnë 3 javë, po flas për tek unë e po besoj edhe të tjerët, pastaj qentë po vijnë e po e shpërndajnë, Dua të di se ku është problemi a nuk ka mjete, a nuk ka makineri, në anën tjetër Kryetari e mori një vendim të cilin e përgëzojmë

por duhet të krijohen kushtet, që së pari të mbledhin mbeturinat pastaj nëse i hedhim atëherë me na ndëshkue. **Kryetari** - Po ka pasur problem me menaxhimin e mbeturinave, që besoj se në dy javët e fundit ky problem është zgjidhë. Makineria e stërvjetuar e KRM "Pastrimi", edhe mosha ka ndikuar pak, por ne së bashku me KRM "Pastrimi" kemi arrit me i siguruar 10 punëtoë dmth e kemi bërë një marrëveshje që ne të subvencionojmë gjysmën e pagave të këtyre punëtorëve, kështu që po besoj që këto dy javë kemi arritë të grumbullohen mbeturinat.

Dorentina Mustafa - Ne jemi dëshmitarë se për shkaqe të reshjeve atmosferike sa shumë dëme janë shkaktuar. Kërkoj nga Komisioni për regjistrimin e dëmeve të jenë të paanshëm dhe të bëjnë vlerësimin në mënyrë profesionale. Për të mos u përsëritë edhe njëherë kjo situatë e tillë kërkoj që të bëhet planifikimi buxhetor që të bëhet thellimi dhe zgjerimi i lumenjve, si masë preventive në mënyrë që të mos përsëriten situata të tilla.

Kryesuesi - Sigurisht se Drejtoritë që merren me këto çështje i marrin parasysh kërkesat e juaja, dhe Drejtoritë janë të vetëdijshme për këtë çështje. Meqenëse, nuk kemi diskutime tjera, atëherë e mbylli seancën e sotme.


Mbledhja përfundoi në ora 12:52'

Zyrtare e lartë për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Sami Ahmeti